



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 2226 Prot

Peshkopi, më 24.06.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.34

Datë: 20.06.2024



“ Për një shtesë në vendimin nr.28 datë 05.04.2024 Për miratimin e Aktit të Themelimit dhe Statusit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “Operatori i rrugëve rurale dhe turistike” (ORRT)”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.507/1 prot.

Peshkopi, më 24.06.2024

Lenda : Për vendimin e këshillit të bashkisë Dibër nr.34 datë 20.06.2024


KESHILLIT BASHKISË DIBER

DIBER

Në mbështetje të ligjit *nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut"*, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e këshillit bashkisë Dibër, *nr. 34 datë 20.06.2024 "Për një shtesë në vendimin Nr. 28 datë 05.04.2024, Për miratimin e aktit të themelimit dhe statutin e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor" Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike (ORRT)" vendosa ;*

Miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit dhe zbatimit rigoroz të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit, kriterëve e kushteve për themelimin e administrimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor në funksion të mirëqënies dhe zhvillimit, veprime që kurdoherë janë përgjegjësi direkte administrative-ligjore e strukturave të posaçme të bashkisë që paraqesin për miratim projekt-akte të kësaj natyre.

PREFEKTI
- Nexhbedin SHEHU -





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 34 Datë 20/06/2024

“ Për një shtesë në vendimin nr.28 datë 05.04.2024 Për miratimin e Aktit të Themelimit dhe Statusit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “Operatori i rrugëve rurale dhe turistike” (ORRT)”.

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, nenit 14 e vijues, nenit 54 gërma “d” të ligjit nr.139/2015 “ Përvetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktit të Themelimit dhe Statusin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “Operator i rrugëve rurale dhe turistike” (ORRT), Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **20.06.2024** me 17 vota pro, 0 kundër dhe 3 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e Aktit të Themelimit dhe Statusit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “Operator i Rrugëve Rurale dhe Turistike” (ORRT), që do të nënshkruhet nga anëtarët themelues : Fondi Shqiptar i Zhvillimit , Bashkia Mat, Bashkia Klos, Bashkia Bulqiz, Bashkia Dibër, Agjensia Ekonomike Mbështetëse “AEM Sh.p.k, Agjensia e Menaxhimit të Investimeve “AMI” Sh.p.k, HUBEX-Qendra e Ekselences për Dije dhe Inovacion dhe AGREGATORI – Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje”.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Dibër për nënshkrimin e Aktit të Themelimit, Statusin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “Operator i Rrugëve Rurale dhe Turistike (ORRT) dhe cdo akti tjetër të nevojshëm për krijimin, regjistrimin dhe funksionimin e kësaj shoqërie si përfaqëues i anëtarit themelues, Bashkia Dibër.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Dibër.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall me datë **20.06.2024**.

Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mario ELIJA

